



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHIJAK  
KRYETARI  
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Shijak, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Blerje materiale ndertimi**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Toner per makinat fotokopjuese**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

1.244.000 (Nje milion e dyqind e dyzete e kater mije ) leke , **pa TVSH.**

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:** Nga data e nënshkrimit të kontratës, operatori ekonomik fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Artikujt duhet të dorëzohen në magazinën e Bashkisë Shijak brenda 20 (njetete) ditëve punë nga lidhja e kontratës.

**BURIMI I FINANCIMIT:** Të ARDHURA NGA BUXHETI I BASHKISË

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 9

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, **sipas Shtojcës 9**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhirove për periudhën financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros minimale vjetore, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43 e 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë ekonomiko-financiare është në raport me objektin e prokurimit bazuar në nenin 55, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku kërkesa për vlerën e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë në

proceduren e hapur te thjeshtuar nuk mund te tejkalojë 40% te vlerës së perlllogaritur të kontratës. Kjo kerkese i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1 të VKM Nr. 285 date 19.05.2021 "Mbi Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Për të provuar kapacitetin teknik Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se **40 %** e vlerës së perlllogaritur te kontrates Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikate të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015, të përkthyer dhe të noterizuara.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe nenin 79

pika2, germa c, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40 dhe 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Keto kërkesa teknike kanë lidhje me objektin e kontratës që prokurohet dhe janë vendosur në raport të drejte dhe të ngushte me objektin e kontratës si dhe lehtësisht të sigurueshme nga çdo operator ekonomik. Autoriteti kontraktor ka respektuar duke vendosur këto kritere edhe parimin e mos diskriminimit për sa kohë këto certifikata janë lehtësisht të sigurueshme.

Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë.

### **Operatori ekonomik të paraqesë një Deklaratë e cila të përmbajë:**

2.3.3 a. Në momentin e dorëzimit të mallit tek autoriteti kontraktor, malli do të shoqërohet me deklaratën e garancisë.

2.3.4 b. Tonerat do të jenë bojra origjinale ose ekuivalente, të pahapura dhe jo të rimbushura, të reja dhe të padëmtuara dhe plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë.

**Argumentim:** Në bazë të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se artikujt objekt prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të se ciles merr persiper të kryejë shërbimin e transportit, të gjithë artikujve.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor.

2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në datën dhe orën e hapjes së ofertave mostër vetëm për tonerat dhe bojrat si më poshtë:

| Nr. | Pajisja                                      | Marka   | Modeli i Tonerit |
|-----|----------------------------------------------|---------|------------------|
| 1   | Brother MFP Color Laser Printer DCP-L8410CDË | Brother | TN-431           |
| 2   | HP Color LaserJet Pro MFP M479fdn            | HP      | W2020A-W2023A    |
| 3   | Kyocera TASKalfa 3551ci                      | Kyocera | TK-8305          |
| 4   | Xerox VersaLink 7025c                        | Xerox   | 106R03870-73     |

Mostrat duhet të jenë të vulosura dhe do të mbeten në dispozicion të AK, të nevojshëm për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave. Mostrat do të kthehen me kërkesë të ofertuesit brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës me operatorin fitues.

***Mospërputhjet ndërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbëjnë kusht për skualifikim.***

**2 Argumentimi:** Neni 40, pika 6, germa a, e VKM NR. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor cmon dhe gjykon se paraqitja e mostrave për keto mallra objekt prokurimi është shumë e domosdoshme sepse janë mallra cilesia e të cilave ndikon direkt në punën e përditshme të autoritetit kontraktor. Mostrat duhet të jenë të vëlosura dhe do të mbeten në dispozicion të AK, të nevojshëm për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave. Mostrat do të kthehen me kërkesë të ofertuesit brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës me operatorin fitues.

### **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

2.3.7 Për efekt të verifikimit të gjendjes gjyqësore Operatorët Ekonomik së bashku me dokumentacionin e kërkuar, duhet të sjellin edhe fotokopjen e certifikatës personale të administratorit ose të ortakëve të shoqërisë (nëse është rasti).

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e certifikatës personale të administratorit të shoqërisë ose të ortakëve të shoqërisë (nëse është rasti).

**Sasia e mallit që kërkohet: E përcaktuar në bazë të konsumit dhe nevojave të AK**

**\*      *Specifikimet teknike bashkëlidhur janë hartuar nga Njësia e Prokurimit në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.***